**VENDIM**
**Nr. 239, datë 17.4.2024**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Pas fjalisë së parë, të pikës 1, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Përjashtim nga ky kriter bëjnë vetëm të rinjtë, të moshës 15–29 vjeç, të cilët do të jenë pjesëmarrës sipas skemës së garancisë rinore dhe personat me aftësi të kufizuara.".

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Punëdhënësit me të drejtë kërkese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë persona fizikë apo juridikë të regjistruar, për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj;

b) Subjekti të jetë në statusin aktiv;

c) Të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vjetët e fundit para kërkesës në program;

ç) Të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës. Punësimi me kohë të pjesshme ose punët sezonale afatshkurtra nuk përfitojnë subvencionim;

d) Të jenë persona fizikë apo juridikë, të cilët nuk kanë detyrime të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, por në momentin e aplikimit në program kanë ende gjoba apo interesa të papaguar.

dh) Vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i shtimit të vendeve të lira të punës në aktivitetin e punëdhënësit.".

3. Fjalia e dytë, e pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Punëdhënësit me deri në 9 (nëntë) punonjës mund të aplikojnë për maksimumi 2 (dy) pjesëmarrës.".

II. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen "ii", të shkronjës "ç", të pikës 1, bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"- për 6 (gjashtë) muaj, për pjesëmarrësit, të cilët janë të rinj të moshës 15–29 vjeç, persona me aftësi të kufizuara, viktima të trafikimit, të dhunës në familje apo viktima të dhunës me baza gjinore, romë dhe egjiptianë, të kompensuara në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës.".

b) Paragrafi i tretë shfuqizohet.

2. Nënndarja "iv", e shkronjës "dh", të pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"iv. pagesën për mentorin në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënës, të kompensuar çdo muaj.".

3. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas fjalëve "... viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore ..." shtohen "... përfituesit e rinj të moshës 15–29 vjeç, personat me aftësi të kufizuara dhe ...".

b) Në shkronjën "a", fjalët "... 1 600 (një mijë e gjashtëqind) ..." zëvendësohen me "... 1 800 (një mijë e tetëqind) ...".

c) Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) për prindërit e vetëm ose prindërit e rinj të moshës 18–29 vjeç me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç jepet një bonus në vlerën prej 4 000 ( katër mijë) lekësh në muaj për kujdesin e çdo fëmije në ngarkim;".

ç) Në shkronjën "c", pas fjalës "... të kufizuara" shtohen "..., në të cilën përfshihen, por pa u kufizuar, mjetet ndihmëse në vendin e punës, literaturë/informacion të përshtatur dhe përkthime për personat me dëmtime shikimi ose dëgjimi, asistent personal në vendin e punës, transport të përshtatur, aksesueshmëri të mjedisit të punës ...".

III. Në kreun IV bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pas marrjes së kërkesës nga punëdhënësi, verifikimet përkatëse për përmbushjen e kritereve të përcaktuara në pikën 4, të kreut II, për punëdhënësin, do të kryhen nga Sistemi i Shërbimeve të Punësimit nëpërmjet ndërveprimit me bazën e të dhënave shtetërore të institucioneve të tjera.".

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Për punëdhënësit që plotësojnë kriteret, struktura vendore e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve punë, identifikon listën e pjesëmarrësve punëkërkues të papunë, që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes në program.".

c) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Financimi i punëdhënësit do të bëhet çdo muaj, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, pas dorëzimit të kërkesës për muajin që kërkon financim.".

IV. Në pikën 4, të kreut V, fjalët "... 5 (pesë) ..." zëvendësohen me "... 10 (dhjetë) ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**